

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË
KOSOVË

P4

ZGJIDHJET

FLETË PROVIMI
Exam Paper

*Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në
këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme*

Data 12.07.2025

Pjesa A: Pjesa A – (1 pikë secila – 30 pikë)

1. Norma standarde e TVSH-së në Kosovë është:

- a) 17 %
- b) 18 %**
- c) 20 %
- d) 8 %

2. Qarkullimi kur subjekti obligohet të regjistrohet për TVSH kalon:

- a) 10 000 €
- b) 25 000 €
- c) 30 000 €**
- d) 50 000 €

3. Norma e Tatimit në të Ardhurat e Korporatave (TAK) në fitimin e tatueshëm është:

- a) 8 %
- b) 9 %
- c) 10 %**
- d) 12 %

4. Humbjet tatimore si pas TAK mund të bartën për një periudhë deri në:

- a) 4 vite**
- b) 6 vite
- c) 8 vite
- d) 10 vite

5. Norma e tatimit në burim për kamata ndaj jo-rezidentëve është:

- a) 0 %
- b) 5 %
- c) 8 %
- d) 10 %**

6. Kontributi pensional i detyrueshëm (punëmarrës) është:

a) 4 %

b) 5 %

c) 6 %

d) 7 %

7. Norma e reduktuar e TVSH-së aplikohet:

a) 5 %

b) 6 %

c) 8 %

d) 9 %

8. Donacionet e zbritshme kufizohen deri në ____ të fitimit para tatimit:

a) 5 %

b) 7 %

c) 10 %

d) 12 %

9. Nëse një veturë luksoze përdoret < 60 % për biznes, TVSH-ja e blerjes:

a) Nuk zbritet

b) Zbritet 50 %

c) Zbritet 60 %

d) Zbritet 100 %

10. Segmenti i pagës mbi 450 € tatohen me normë:

a) 4 %

b) 8 %

c) 9 %

d) 10 %

11. Cili është **afati përfundimtar** (data) brenda të cilit një individ rezident duhet ta dorëzojë deklaratën vjetore të të ardhurave personale për vitin tatimor të përfunduar?

a) 31 Mars

b) 30 Prill

c) 31 Maj

d) 30 Qershor

12. Baza e TVSH-së në import përfshin:

a) Dogana

b) Kosto (CIF) + Dogana + Akciza (nëse ka)

c) Vetëm transportin

d) Nuk aplikohet TVSH

13. Kontributi pensional i detyrueshëm i punëdhënësit është:

a) 3 %

b) 5 %

c) 7 %

d) 10 %

Ligji për Shoqëritë Tregtare

14. Kapitali minimal i autorizuar për Shoqërinë Aksionare është:

a) 10 000 €

b) 20 000 €

c) 25 000 €

d) 30 000 €

15. Në një SH.P.K. numri maksimal i pronrve lejohet të jetë:

- a) 25
- b) 50
- c) 100
- d) Pa kufizim

16. Bordi i Drejtorëve duhet të thërrasë Asamblenë e Aksionarëve të paktën:

- a) Një herë në 3 muaj
- b) Dy herë në vit
- c) Një herë në vit
- d) Sipas kërkesës së auditorit

17. Sipas ligjit, cilën nga deklaratat e mëposhtme e përshkruan saktë marrëdhënien midis aksioneve të **certifikuara** dhe atyre **pa-certifikuara** kur janë të së njëjtës kategori?

- a) Vetëm aksionet e certifikuara gëzojnë të drejtë vote.
- b) Vetëm aksionet e pa-certifikuara marrin dividendë.
- c) Aksionet e certifikuara dhe pa-certifikuara të të njëjtit lloj dhe kategori kanë të drejta identike.
- d) Aksionet e certifikuara mund të kenë privilegje shtesë ndaj atyre pa-certifikuara.

Ligji i Punës

18. Kontrata e punës pa afat mbi 10 vite punësim mund të ndërpritet me paralajmërim minimal:

- a) 7 ditë
- b) 15 ditë
- c) 30 ditë
- d) 60 ditë

19. Pushimi vjetor minimal për punonjës me ≥ 10 vite përvojë është (ditë pune):

- a) 18
- b) 20
- c) 22
- d) 30

20. Pagesa minimale ligjore për punën jashtë orarit është e paktën:

- a) +15 %
- b) +20 %
- c) +30 %
- d) +50 %

21. Cili është afati maksimal i lejuar i periudhës së provës për një punonjës të ri?

- a) 3 muaj
- b) 4 muaj
- c) 6 muaj
- d) 12 muaj

Ligji për Administrimin e Procedurave Tatimore

22. Afati maksimal i rimbursimit të TVSH-së nga ATK-ja është:

- a) 15 ditë
- b) 30 ditë
- c) 60 ditë
- d) 90 ditë

23. Norma mujore e interesit për pagesat e vonuara tatimore është:

- a) 0,35 %
- b) 0,50 %
- c) 0,65 %
- d) 0,75 %

24. Gjopa fikse për mos-aplikim për regjistrim në TVSH-së është:

- a) 50 €
- b) 120 €
- c) 150 €
- d) 300 €

25. Afati i kontrollimit të deklaratës nga ATK është:

- a) 3 vite
- b) 4 vite
- c) 6 vite
- d) 7 vite

26. Afati minimal i ruajtjes së regjistrave tatimorë është:

- a) 3 vite
- b) 5 vite
- c) 6 vite
- d) 7 vite

Ligji për Kontabilitet, Auditim dhe Raportim Financiar

27. Një ndërmarrje mikro klasi I NUK detyrohet të:

- a) Përdorë plan kontabël
- b) Përgatisë pasqyrë fluksi të parasë
- c) Dorëzojë pasqyrat në ARBK
- d) Ruajë librat 6 vite

28. Auditimi ligjor është obligativ nëse është plotësuar një kushte dhe qarkullimi vjetor tejkalon:

- a) 200 000 €
- b) 500 000 €
- c) 1 000 000 €
- d) 4 000 000 €

29. Kategorinë Entitet me Interes Publik e përbëjnë:

- a) SH.P.K. ≥ 10 punonjës
- b) Institucione financiare dhe sigurues
- c) Vetëm shoqëritë e aksionare
- d) Ndërmarrje me kapital publik $> 25 \%$

30. Parimi i kontinuitetit njihet si:

- a) Accrual basis
- b) Going concern**
- c) Materiality
- d) Consistency

Pjesa B – 3 Studime rasti me 5 pyetje objektive secila (30 pikë)

Rasti 1: TechConsult SH.P.K.

(10 pikë)

TechConsult ofron shërbime IT në Kosovë dhe jashtë vendit. Për vitin 2024 ka këto të dhëna:

- Shitje shërbimesh në Kosovë : 400 000 € (vlëra pa TVSH);
- Shitje konsulence në BE : 60 000 €;
- Fakturë nga kompani gjermane për licencë softueri(për 3 vite): 24 000 € (vlëra pa TVSH);
- Blerje laptopësh vendore (me TVSH 18 %): 17 700 €;
- Pagoi honorare konsulence një eksperti shqiptar jo-rezident: 15 000 € .
- Kosto të tjera të pranueshme (pa TVSH): 220 000 €.

31. TVSH e llogaritur e faturuar në Kosovë është:

- a) 72 000 €**
- b) 56 000 €
- c) 0 €
- d) 64 800 €

32. TVSH-ja e llogaritur me ngarkesë të kundërt për licencën është:

- a) 4 320 €**
- b) 3 600 €
- c) 2 880 €
- d) 1 440 €

33. TVSH e zbritshme nga blerja e laptopëve është:

- a) 2 700 €**
- b) 3 186 €
- c) 1 700 €
- d) 0 €

34. Tatimi në burim për honorarin e jo-rezidentit është:

- a) 0 €
- b) 750 €
- c) 1 500 €
- d) $10 \% \times 15\,000\,€$

35. Fitimi tatueshëm (para zbritjes së TAK) është më afër:

- a) 215 680 €
- b) 208 000 €
- c) 240 000 €
- d) 260 000 €

Rasti 2: AgroFresh L.L.C.

(10 pikë)

Agro Fresh prodhon lëngje frutash.

- Shitje me normë e reduktuar: 220 000 € (vlera pa TVSH)
- Shitje me normë standarde: 180 000 € (vlera pa TVSH)
- Import koncentratit frutash CIF 90 000 €; doganë 10 000 €; akcizë 0 €
- Blerje vendore ambalazhi : 35 400 € (vlera pa TVSH)
- Blerje energji: 54 000 € (vlera pa TVSH)
- Shpenzime e kërkimit dhe zhvillimit 25 000 € (8 000 € të kapitalizuara), pjesa e amortizimit 1/5.
- Pagat bruto 120 000 €
- Pa stok ne fund te vitit

36. TVSH e llogaritur për shitjet është:

- a) 18 360 €
- b) 50 000 €
- c) 60 840 €
- d) 63 720 €

37. TVSH në import të koncentratit është:

- a) 14 400 €
- b) 18 000 €
- c) 17 820 €
- d) 19 800 €

38. TVSH e zbritshme nga ambalazhi është:

- a) 5 400 €
- b) 6 372 €**
- c) 4 800 €
- d) 0 €

39. Kufiri i zbritjes së kerkimimit dhe zhvillimit si shpenzim (pa kapitalizuar) është:

- a) 100 %**
- b) 80 %
- c) 75 %
- d) 90 %

40. TAK-i pagueshëm (10 %) është më afër:

- a) 20 000 €**
- b) 24 000 €
- c) 27 000 €
- d) 30 000 €

Rasti 3: ModernHomes Sh.A.

(10 pikë)

- ModernHomes zhvillon apartamente rezidenciale. Projekti “Panorama” ka:
 - Tokë blerë 800 000 €
 - Kosto ndërtimi 2 500 000 € (vlëra pa TVSH)
 - Shitje të kontraktuara të apartamenteve 4 200 000 € në vitin 2024 - viti i parë (pagesë 30 % gjatë vitit)
 - Kosto të financimit 150 000 €
 - Blerje shërbime arkitekurore nga Itali 120 000 €
 - Shitje të garazhe 200 000 € (pagesë 30% gjatë vitit)
- Koeficienti i zbritshëm i TVSH-së = 85 %.
- Te gjitha shitjet janë te kontraktuara
- Projekti zgjatë dy vite

41. TVSH e llogaritur për shitjet e apartamenteve (2024) është:

- a) 680 400 €
- b) 756 000 €
- c) 648 000 €
- d) 0 €

42. TVSH e zbritshme me ngarkesë të kundërt për shërbimin arkitekturor është:

- a) 21 600 €
- b) 18 360 €
- c) 14 400 €
- d) 0 €

43. TVSH e zbritshme për koston e ndërtimit është:

- a) 450 000 €
- b) 400 860 €
- c) 387 000 €
- d) 212 500 €

44. TVSH për shitjen e garazheve është:

- a) 0 €
- b) 36 000 €
- c) $200\,000\text{ €} \times 8\%$
- d) 3 600 €

45. FITIMI tatueshëm (TAK) për 2024 është më afër:

- a) 298 332 €
- b) 1 050 000 €
- c) 227,778 €
- d) 750 000 €

Pjesa C – Pyetje me përgjigje të zhvilluara (40 pikë)

Problemi 1

(10 pikë)

TechVision Hub L.L.C. (Prizren) zhvillon softuer, tregon pajisje inteligjente dhe ofron shërbime IT brenda e jashtë Kosovës. Vlerat janë **pa TVSH** nëse nuk theksohet ndryshe.

Përshkrimi	Vlera (€)	Vërejtje
1 Shitje softuerësh – eksport	150 000	
2 Shitje pajisjesh – treg vendor	300 000	
3 Shërbime mirëmbajtjeje & konsulence – vendor	50 000	(çmimi me TVSH)
4 Projekte softuerike për institucione publike	120 000	
5 Shpz. Kerkimore dhe zhvillimore	40,000	(amortizohet 20 %)
6 Shpenzime administrative & menaxhimi	25 000	
7 Marketing & promovim	12 000	
8 Blerje pajisje zyre & mirëmbajtje	18 000	(çmimi me TVSH)
9 Stoqe fillimi (01.01.2023)	80 000	
10 Stoqe mbyllje (31.12.2023)	100 000	
11 Pagat bruto (përfshin 5 % kontribut punëdhënësi)	70 000	
12 Import pajisjesh për shitje	220 000	(çmimi me TVSH)
13 Udhëtime & trajnime jashtë vendit	15 000	
14 Zhvlerësim kontabël i pajisjeve	30 000	
15 Shpenzime ligjore & avokatë	10 000	(çmimi me TVSH)
16 Donacione për OJQ të licencuara	5 000	Zbritje e kufizuar sipas ligjit
17 Sponsorizim sportiv (klub i regjistruar)	7 000	Zbritje e kufizuar ligjit
18 Tërheqje personale e pronarit	30 000	

Kërkesat

a) Llogaritni **të ardhurat neto** nga shitjet dhe përcaktoni bazën e **të ardhurave tatueshme** për vitin 2023.

b) Llogaritni **Koston e Mallrave të Shitura (KMSH)** për pajisjet teknologjike:

c) Përgatitni llogaritjen e **fitimit tatueshëm** dhe **TAK 10 %**:- zbatoni kufijtë ligjorë.

Zgjidhje

Përshkrimi	Shuma (€)
Të ardhura	
• Shitje softuerësh (eksport, 0 %)	150,000
• Shitje pajisjesh (vendor, 18 %)	300,000
• Shërbime mirëmbajtjeje (vendor, 8 %) → 50 000 / 1,08	46,296
• Projekte softuerike për institucione publike	120,000
Të ardhura neto	616,296
Kosto e mallrave të shitura (shih b)	166,441
Fitim bruto	449,855
Shpenzime operative të zbritshme	
• Pagat & kontributi punëdhënësi (5 %)	70,000
• Administrim & menaxhim	25,000
• Marketing	12,000
• Udhëtime & trajnime	15,000
• Shpenzime ligjore (10 000 / 1,18)	8,475
• Amortizim kontabël ekzistues	30,000
• Amortizim K&ZH (40 000 × 20 %)	8,000
• Amortizim pajisje zyre dhe mirembajtje (18,000/1,18)	15,254
• Donacioni	5,000
Sponsorizimi	7,000
Totali shpenzime operative	195,729
Fitim para rregullimeve	254,126
Rregullimi	
Sponsorizimi	7,000
Fitimi I tatueshëm	261,126

b) Kosto e Mallrave të Shitura (KMSH)

Komponenti	Llogaritja	Vlera neto €
Stoqe hapje	Vlera e inventarit më 1 janar 2023	80,000
Blerje neto (import)	Çmim importi me TVSH 220 000 / 1,18	186,441
Stoqe mbyllje	Inventari në fund të vitit (31 dhj 2023)	100,000
KMSH	80 000 + 186 441 – 100 000	166,441

c) Fitimit tatueshëm dhe TAK

Fitim para rregullimeve	254,126
Rregullimi	
Sponsorizimi	7,000.00
Fitimi I tatueshem	261,126.00
Tatimi 10%	26,113.00
Sponsorizimi (max 30% e tatimit)	7,000.00
Obligimi I tatimit per pagese	19,112.60

Pyetja 2

20 pikë

RoyalResort LLC operon hotel me spa. Në shtator 2024:

- Shitje akomodimi 1 200 000 € (TVSH 18 %) (70 % pagesë në vit, 30 % depozita të parapaguara),
- Shitje restorant & bar 740 000 € (TVSH 18 %),
- Shërbime spa e trajtime wellness 260 000 € (TVSH 18 %),
- Shitje paketash turistike për jashtë (komision 50 000 €),
- Blerje ushqime & pije (TVSH 18 %): 345 600 €,
- Blerje inventar dhomash (me TVSH 18 %): 120 000 €,
- Riparime kapitalizuar (TVSH 18%): 400 000 € (pritet t'u nënshtrohet rregullit të aseteve kapitale – rregullimet 1/5 vjet),
- Pagat bruto 450 000 € (plus 5 % +5 % kontribute),
- Shpenzime marketingu 90 000 € (TVSH 18 %),
- Interes kredie 80 000 €.

Kërkesa:

a) Hartoni deklaratën mujore të TVSH-së për Shtator 2024, duke llogaritur TVSH e llogaritur dhe TVSH e zbritshme (koeficient zbritshëm 95 % për shpenzimet e përziera); Vlerat janë pa përfshirë TVSH-ne

b) Llogaritni TAK për 2024, duke marrë parasysh zhvlerësimin tatimor (grupi II 20 % nga inventari kapitalizuar).

Zgjidhje

a) DEKLARTA E TVSH-se

Furnizimi (shitjet)	Baza €	Norma	TVSH €		
Akomodim	1,200,000	18%	216,000.00		
Restorant & bar	740,000	18%	133,200.00		
Spa & wellness	260,000	18%	46,800.00		
Komisionet	50,000				
TVSH e llogaritur (dalëse)			396,000.00		

Furnizimi (blerejt)	Baza €	Norma	TVSH bruto	Koef.	TVSH e zbritshme
Ushqime & pije (kuzhinë)	345600	18%	62,208	95%	59,097.60
Inventar dhomash	120000	18%	21,600	95%	20,520.00

Riparime kapitale (asete)	400000	18%	72,000	95%	68,400.00
Marketing (shpenzim i përzier)	90000	18%	16,200	95%	15,390.00
TVSH e zbritshme					163,407.60

TVSH për t'u paguar = 396,000 – 163,407.60 = 232,592.40

b) Tatimi në të Ardhurat e Korporatave

Përshkrimi	Shuma €
Akomodim (1,200,000 x 70%)	840,000
Restorant & bar	740,000
Spa & wellness	260,000
Komision paketa turistike (i përjashtuar nga TVSH)	50,000
Të ardhura totale	1,890,000
Shpenzim	
Ushqime & pije (KMSH)	345,600.00
Paga	450,000.00
Marketing	90,000.00
Interes kredie	80,000.00
Zhvleresimi tatimor inventar dhomash (120,000 + 1,080) x20%	24,216.00
Zhvleresimi ne riparim (400,000+3,600 TVSH) x 20%	80,720.00
5% TVSH e papranuar e blerjeve (3,110+810)	3,920.00
Shpenzime totale	1,074,456.00
Fitimi I Tatushem	815,544.00
TAK 10%	81,554.40

Problemi 3

(5 pikë)

NovaTech Solutions L.L.C. (them. 2019) operon në sektorin e inovacioneve teknologjike në Kosovë. Në fund të vitit fiskal 2023, kompania duhet të harmonizojë politikat e zhvlerësimit kontabël (bazuar në IFRS) me rregullat e Ligjit nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave. Diferencat midis normave kontabël dhe atyre tatimore ndikojnë në fitimin tatueshëm dhe detyrimet TAK.

Normat vjetore të zhvlerësimit

- Politikat kontabël (metoda lineare) → Grupi I 4 % | Grupi II 15 % | Grupi III 12 %
- Ligji tatimor → Grupi I x % | Grupi II x % | Grupi III x %

Grupi	Aseti	Kosto (€)	Vërejtje
I	Selia qendrore	80 000	
I	Magazinë & Infrastrukturë logjistike	120 000	
II	Furgon për shpërndarje	45 000	
II	Serverë & storage (IT) -	90 000	
III	Printer 3D industrial	100 000	
III	Makineri CNC për prototipim	130 000	

Kërkesat

1. Llogaritni zhvlerësimin tatimor 2023 për secilin aset sipas normave ligjore të grupeve I–III.
2. Krahasoni zhvlerësimin kontabël me zhvlerësimin tatimor dhe identifikoni diferencat kohore.
3. Analizoni ndikimin e diferencave në fitimin tatueshëm dhe në TAK për vitin 2023.

Zgjidhje

Grupi	Aseti	Kosto (€)	Normë kontabël	Zhvl. kontabël 2023	Normë tatimore (TAK)	Zhvl. tatimor 2023	Diferencë (Tatim - Kont.)
I	Selia qendrore	80,000	4%	3,200	5%	4,000	+800
	Magazinë & infrastrukturë	120,000	4%	4,800	5%	6,000	+ 1 200
Grupi I në total		200,000		8,000		10,000	+ 2 000
II	Furgon shpërndarje	45,000	15%	6,750	20%	9,000	+ 2 250
	Serverë & storage IT	90,000	15%	13,500	20%	18,000	+ 4 500
Grupi II në total		135,000		20,250		27,000	+ 6 750
III	Printer 3D industrial	100,000	12%	12,000	10%	10,000	- 2 000
	Makineri CNC	130,000	12%	15,600	10%	13,000	- 2 600
Grupi III në total		230,000		27,600		23,000	- 4 600
Totale		565,000		55,850		60,000	+ 4 150

3. Ndikimi në fitimin tatueshëm dhe në TAK

Përshkrimi	€
Amortizim kontabël (që ul fitimin kontabël)	55,850.00
Amortizim tatimor (i lejuar)	60,000.00
Ulje shtesë e fitimit tatueshëm	4,150.00
Norma tatimore	10%
Ulje e TAK 2023	415 €

Problemi 4

(5 pikë)

DataWave Analytics L.L.C., një kompani e licencuar për shërbime të analitikës së të dhënave dhe konsulencë biznesi, duhet të përgatisë listën e pagave për muajin Tetor 2024 në përputhje me Ligjin për Tatimin në të Ardhurat Personale (TAP) dhe Ligjin për Fondet Pensionale (kontributet e detyrueshme 5 % + 5 %).

Shkallët progresive mujore të TAP (2024):

Stafi & komponentët e pagës për Tetor 2024

Nr.	Punonjësi / Pozicioni	Paga Bruto (PB) (€)	Koment
1	Ardian M. – CEO	4 500	Në PB është përfshirë një bonus performance 700 €
2	Blerina G. – CFO	2 800	
3	Drilon K. – Senior Data Engineer	1 950	Në PB është përfshirë 250 € orë shtesë
4	Erza P. – QA Lead	1 300	
5	Fjolla S. – Sales Manager	1 100	Nuk është përfshirë një provizion shitjesh 200 €
6	Gëzim L. – HR Specialist	850	
7	Ilir R. – Junior Analyst	600	
8	Jonida T. – Support Agent	420	

Kërkesat

1. Llogaritni kontributin pensional të mbajtur nga secili punëmarrës, si dhe kontributin të punëdhënësit.
2. Përllogaritni TAP-in mujor për secilin punonjës, duke zbatuar shkallët progresive.
3. Përcaktoni pagën neto (bruto – kontribut punëmarrës – TAP).
4. Llogaritni koston totale të punëdhënësit për secilin punonjës (paga bruto + 5 % kontribut punëdhënësit).
5. Përcaktoni totalin e kosto-pagave të punëdhënësit për muajin Tetor 2024.

Punonjësi	Bruto €	5 % Kontr. (p	Baza TAP	TAP €	Neto €	5 % Kontr. (p	Kosto punëdhënës
Ardian M. – CEO	4,500	225	4,275	399	3876.5	225	4,725
Blerina G. – CFO	2,800	140	2,660	237	2423	140	2,940
Drilon K. – Sr Data Eng.	1,950	98	1,853	156	1696.25	98	2,048
Erza P. – QA Lead	1,300	65	1,235	95	1140.5	65	1,365
Fjolla S. – Sales Mgr	1,300	65	1,235	95	1140.5	65	1,365
Gëzim L. – HR Spec.	850	43	808	52	755.75	43	893
Ilir R. – Junior Analyst	600	30	570	28	542	30	630
Jonida T. – Support Ager	420	21	399	12	387.08	21	441
Totali	13,720	686		1,072	11,961.58	686	14,406